

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FJORDI P” Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me daten 28.03.2024 (dymije e njezet e kater) shtetasi:

1 Z. Jashar Poçi

Mblidhet, diskuton, bien dakort dhe vendos sa vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare **FJORDI P Sh.p.k.**

Nga Ortaku themelues:

- 1- **Z. Jashar Poçi**, shtetas Shqiptar, , lindur me 02.04.1952 ,i biri i Bajram mbajtes i Kartes se Identitetit ID Nr F20402081B lindur ne Melan Peshkopi dhe banues Tirane.

Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne adresen:

Njesia Bashkiake Nr 6 Rruga Teodor Keko Rezidenca Futura Home Kulla nr 2,Kati i 1 Ap CIA2 Zona Kadestrale 3866 Astir Tirane

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.

Me vendim te ortakeve, mund të krijohen ose anulohen seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi edhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali i shoqerise

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë, është **2.000.000** (Dy Milion) lekë i ndare ne 1 kuote Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- Zoti **Jashar Poçi** zoteron 100% kuota ose **2.000.000** (Dy Milion) leke te kapitalit 1 kuote

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Ortaket mund te shesin kuotat e tyre personave te trete ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te aplikuar dhe parshikimeve te statutit te kesaj Shoqerie.

Transferimi i Kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe pergjithesisht siç parashihet ne ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Në rastet e bashkëpronësisë vepohet ne zabatim te legjislacionit ne fuqi.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise dhe me investime personale te ortakeve konform miratimit paraprak te asamblese se ortakeve..

Ortakët kanë të drejtë pronësi mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi, në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Shoqëria çel llogari bankare në monedhë shqiptare si edhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortakët e Shoqërisë ose Administratori i emëruar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria bankare.

NENI 8

Ortakët, kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tyre përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor. Transferimet duhet të jenë të vertetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim Asambleja e Ortakëve.

Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 9

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë :

. Studime projektimi në fushën e ndërtimit ,ndërtime civile dhe industriale,rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale ,veshje fasada,punime rifiniture të muratës,rifiniture me materiale druri,plastike,metalike dhe xhami.Punime germimi ,punime nëntokesore,rruge,autostrada,mbikalme,ura e vepra arti,diga e tunele hidroteknike,ujesjellesa e vepra kullimi e vaditje,punime dhe mbrojtje lumore,sisteme hidraulike dhe bonifikues .

Shoqëria do të kryej çdo veprimtari të ligjshme dhe/ose të angazhohet në çdo lloj aktiviteti sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 10

Me vendim të Asamblese së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarvajtjen e shoqërisë.

NENI 11

Me vendim të Asamblese se ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 12

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i njej asamblese se ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose me shumë administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokures.

NENI 13

Administrator i shoqërisë FJORDI P Sh.p.k. është:

Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administratori i shoqërisë "FJORDI P" shpk për një periudhë 5-vjeçare do të jetë

Z...Jashar Poçi madhor, lindur me 02.04.1958 ,i biri i Pjeter mbajtes i ID Nr F20402081B.

Administratori i shoqërisë gëzon të gjitha të drejtat që ligji « Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » parasheh, pa asnjë kufizim të kompetencave.


Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 14

Ky akt themelimi u redaktua në 5 ekzemplare, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe është i vlefshëm kur vertetimi i autenticitetit të nënshkrimit është bërë nga Noteri.

ASAMBLEA E ORTAKËVE

JASHAR POÇI



Tiranë me , 28.03.2024